



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 18

Tiranë – E premte, 13 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 4.2.2015	Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administratave rajonale të zonave të mbrojtura..... 821
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 12.2.2015	Për shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale..... 823
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nr. 5, datë 9.2.2015	Për shpërndarjen e fondit për shtyllën e parë (infrastruktura vendore dhe rajonale), thirrja e parë..... 825



VENDIM

Nr. 102, datë 4.2.2015

**PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË AGJENCISË KOMBËTARE TË
ZONAVE TË MBROJTURA DHE TË
ADMINISTRATAVE RAJONALE TË
ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 23, të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në vijim AKZM, si person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Mjedisit, me seli në Tiranë.

2. AKZM-ja ka për qëllim ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyrës e biodiversitetit, nëpërmjet menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura me interes kombëtar e ndërkombëtar, mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit, edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimit të publikut për zonat e mbrojtura dhe mbështetjes së aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda këtyre zonave.

3. AKZM-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen me urdhër nga titullari. Stema përbëhet nga Stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të Stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”.

4. Vula zyrtare e AKZM-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e AKZM-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II

ORGANIZIMI I AKZM-së

1. AKZM-ja ka statusin e Drejtorisë së Përgjithshme, në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet sipas administratave të zonave të mbrojtura.

2. AKZM-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura.

3. Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së emërohet, lirohet nga detyra sipas përcaktimeve të legjislacionit të shërbimit civil.

4. Funksionimi i brendshëm i AKZM-së bëhet sipas rregullores përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të kësaj agjencie.

5. Administratat e zonave të mbrojtura (AdZM) drejtohen nga drejtuesit përkatës të tyre.

6. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të administratave të zonave të mbrojtura miratohet nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

7. Struktura dhe organika e punonjësve të AKZM-së dhe të AdZM-ve miratohen me urdhër të Kryeministrit.

KREU III

BUXHETI

1. AKZM-ja është institucion buxhetor, që financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme. Buxheti i AKZM-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura.

2. AKZM-ja siguron të ardhura edhe nga shërbimet e kryera prej saj ndaj palëve të tjera. Tarifat e këtyre shërbimeve përcaktohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

3. AKZM-ja administron të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe ato të siguruar nga donacionet dhe shërbimet ndaj palëve të tjera, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. AKZM-ja harton projektbuxhetin vjetor në bazë të projektprogramit vjetor të saj dhe ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të cilin ia përcjell ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura.



KREU IV PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E AKZM-SË DHE AdZM-ve

1. AKZM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas rrjetit të zonave të mbrojtura të miratuara dhe atyre që parashikohen të miratohen në të ardhmen.

2. AKZM-ja dhe AdZM-të kanë detyra dhe përgjegjësi të ngarkuara nga legjislacioni mjedisor në fuqi dhe nga ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura, por ndër më kryesoret janë:

a) Menaxhojnë rrjetin e zonave të mbrojtura, habitateve dhe llojeve natyrore e gjysmënatyrore me interes të ruajtjes, sipas ligjeve kombëtare dhe konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare, nëpërmjet:

- mbështetjes së ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura për hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive e programeve të qeverisë në fushën e zonave të mbrojtura dhe ruajtjes së natyrës;

- hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura;

- hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit për habitatet dhe llojet me interes ruajtjeje;

- mbikëqyrjes së veprimtarive në zonat e mbrojtura dhe sigurimit të pajtueshmërisë së tyre në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet të e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

- propozimit të ndryshimeve dhe përmirësimit të kuadrit ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të rrjetit të zonave të mbrojtura;

- përcaktimit të rregullave të brendshme të veprimit për administratat e zonave të mbrojtura;

- monitorimit të zbatimit me përpikëri të instrumenteve të planifikimit e zhvillimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore dhe vendore në zonat e mbrojtura;

- kontrollit të aktiviteteve që përdorin burimet natyrore brenda rrjetit të zonave të mbrojtura;

- bashkëpunimit me organet përkatëse për zbatimin e aktiviteteve ndërkufitare që lidhen me ruajtjen, zhvillimin dhe monitorimin e rrjetit të zonave të mbrojtura.

b) Promovojnë dhe mbështetin grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit, edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin e publikut për zonat e mbrojtura, nëpërmjet:

- krijimit dhe përditësimit të bazës së të dhënave

për zonat e mbrojtura dhe të rrjetit ekologjik të vendit;

- bashkërendimit të punës për hartimin e programeve dhe ngritjen e rrjetit të monitorimit për biodiversitetin dhe rrjetin e zonave të mbrojtura bashkë me strukturat e Ministrisë së Mjedisit;

- grumbullimit të informacioneve dhe kryerjes së monitorimit në zonat e mbrojtura për gjendjen e biodiversitetit, habitateve, popullatave të llojeve të florës e faunës së egër dhe ekosistemeve natyrore, në bashkëpunim me institucionet e specializuara;

- promovimit të vlerave të zonave të mbrojtura dhe administrimit e funksionimit të qendrave të pritjes dhe informimit të vizitorëve;

- krijimit dhe mirëmbajtjes së shërbimeve e informacioneve për vizitorët në zonat e mbrojtura;

- kontributit në informimin, konsultimin dhe sigurimin e aksesit të publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të rrjetit të zonave të mbrojtura e të biodiversitetit.

c) Mbështetin zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda zonave të mbrojtura, nëpërmjet:

- promovimit të pjesëmarrjes aktive të aktorëve në menaxhimin e zonave të mbrojtura;

- kontrollit për zbatimin e rregulloreve dhe kritereve për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura;

- kryerjes së aktiviteteve të tjera me interes publik në bazë të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;

- monitorimit e respektimit të kritereve ligjore për kryerjen e veprimtarive ekonomike që zhvillohen brenda territorit të zonave të mbrojtura;

- lajmërimit të organeve shtetërore kompetente në rastet kur vërehen shkelje administrative, veprime a mosveprime në kundërshtim me ligjin, duke u propozuar organeve përkatëse marrjen e masave ndaj personave përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi;

- administrimit të pasurive të paluajtshme shtetërore dhe publike, të cilat i kalohen në përgjegjësi administrimi, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KREU V PROCEDURAT E REKRUTIMIT

1. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AKZM-së rregullohen sipas procedurave të



parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

2. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të administratave të zonave të mbrojtura rregullohen sipas Kodit të Punës.

3. Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministri i Mjedisit që, brenda 2 (dy) javëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të marrë masat për paraqitjen e propozimit të Kryeministrit për:

i) emërimin e drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së;

ii) strukturën dhe organikën e AKZM-së dhe AdZM-ve.

2. Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së, mbështetur nga njësitë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse të Ministrisë së Mjedisit dhe në përputhje me kërkesat specifike për arsimin e punonjësve, miraton kërkesat specifike për çdo vend pune në AKZM dhe AdZM.

3. Nëpunësit që do të transferohen nga drejtoritë e shërbimit pyjor në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, transferohen në detyra të reja, pranë AKZM-së dhe AdZM-ve, brenda numrit dhe pozicioneve të organikës së miratuar sipas urdhrit përkatës të Kryeministrit.

4. Nëpunësit ekzistues, që nuk mund të transferohen në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Administratën e Zonave të Mbrojtura, mbeten në institucionet përkatëse, të cilat riorganizohen brenda një periudhe 2-mujore nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministri i Mjedisit, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përcakton edhe rishpërndarjen e mjediseve e mjeteve të punës, si dhe merr masat e duhura për financimin me fonde buxhetore të AKZM-së dhe AdZM-ve për vitin buxhetor 2015.

6. Dispozitat e krerëve II dhe V, për mënyrën e rekrutimit të punonjësve të AKZM-së dhe AdZM-ve, i shtrijnë efektet e tyre tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit.

8. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 134, datë 12.2.2015

PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE MBI SIPËRFAQET TAKUESE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “c”, dhe 5, pika 2, të ligjit nr. 10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale në qarkun e Vlorës.

2. Vlera e përgjithshme e kompensimit për sipërfaqen 904.97 (nëntëqind e katër pikë nëntëdhjetë e shtatë) m², që shpronësohet, është 7 511 251 (shtatë milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) lekë, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të kryejë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, Agjencia e



Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT

AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE
DREJTORIA ALUIZNI QARKU VLORE

DATA BASE E PRONARËVE DHE MASA E SHPËRBLIMIT PËR PASURITË E PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE

NR.	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	QARKU	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	NR. I SUBJEKTEVE	SIPERFAQJA E PARCELËS PËR KOMPENSIM	VLERA E TREGUT PËR TRUALL (lekë/m²)	VLERA E SHPËRBLIMIT (lekë)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	FITNETE		AGALLIU	VLORE	8605	33/323	1	19.29	8,300	160,107
2	AFRIM		AGALLIU							
3	DASHAMIR		AGALLIU							
4	TEFERI		AGALLIU							
5	MARJANA		AGALLIU							
6	FITNETE		AGALLIU	VLORE	8605	33/333	2	9.72	8,300	80,676
7	AFRIM		AGALLIU							
8	DASHAMIR		AGALLIU							
9	TEFERI		AGALLIU							
10	MARJANA		AGALLIU							
11	REFIT		AGALLIU							
12	MEHMET		AGALLIU							
13	FITNETE		AGALLIU	VLORE	8605	33/335	3	224.96	8,300	1,867,168
14	AFRIM		AGALLIU							
15	DASHAMIR		AGALLIU							
16	TEFERI		AGALLIU							
17	MARJANA		AGALLIU							
18	REFIT		AGALLIU							
19	MEHMET		AGALLIU							
20	FITNETE		AGALLIU	VLORE	8605	2/208	4	651.00	8,300	5,403,300
21	AFRIM		AGALLIU							
22	DASHAMIR		AGALLIU							
23	TEFERI		AGALLIU							
24	MARJANA		(DRASH) AGALLIU							
TOTALI								904.97		7,511,251

**VENDIM****Nr. 5, datë 9.2.2015**

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR
SHTYLLËN E PARË (INFRASTRUKTURA
VENDORE DHE RAJONALE), THIRRJA
E PARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për disa projekte të infrastrukturës vendore, për thirrjen e parë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe për të rishpërndarë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të paraqesin kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik e të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, pranë sekretariatit teknik për infrastrukturën vendore, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, brenda një jave nga data e publikimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

4. Ngarkohet sekretariati teknik në Ministrinë e Zhvillimit Urban të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm (Njësisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik), sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI**Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.

**Tabela 1.** Projektet fituese për financim të infrastrukturës vendore dhe rajonale, thirrja e parë

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i Projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Financimi 2015 (lekë)	Financimi 2016 (lekë)
Qarku Durrës					
1	Bashkia Durrës	Rikualifikimi i hapesirave në të dyja anët e rrugës "Pavarësia" dhe sistemit e rrugëve dalëse në plazh - Loti 1	350,000,000	245,000,000	105,000,000
2	Bashkia Durrës	Rikualifikimi i fasadave në qytet	108,042,680	75,629,876	32,412,804
3	Bashkia Durrës	Rikonstruksion i pishinës publike	50,000,000	35,000,000	15,000,000
4	Bashkia Shijak	Rehabilitimi i qendrës së qytetit të Shijakut	98,196,400	68,737,480	29,458,920
Qarku Elbasan					
5	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugës te pallati i sportit	37,396,878	26,177,815	11,219,063
6	Bashkia Elbasan	Sistemim i rrugës Marie Dhama dhe sheshet e pallateve	23,986,151	16,790,306	7,195,845
7	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugës Nusret Kokobobo dhe i shesheve të pallateve (60,61,62,63/1, 64/3), Lagje Emin Matraxhiu, Elbasan	42,824,044	29,976,831	12,847,213
8	Bashkia Elbasan	Suvatim dhe lysterje fasadash në rrugët kryesore për 100 banesa kolektive	137,262,490	96,083,743	41,178,747
9	Bashkia Librazhd	Sistemim, asfaltim, rrugë dhe shesh "bllloqet e banimit, tregu i qytetit + sheja, lagje e re-Ushtaraku dhe Shkumbini"	98,366,386	68,856,470	29,509,916
Qarku Fier					
10	Bashkia Fier	Rikualifikimi urban i rrugës Muharrem Agolli (Pedonale)	198,427,271	138,899,090	59,528,181
11	Bashkia Lushnje	Rijetësimi i shëtitores Kongresi	150,000,000	105,000,000	45,000,000
12	Bashkia Lushnje	Rikualifikimi i Zonës pranë varrezave publike	17,477,445	12,234,212	5,243,233
13	Bashkia Divjake	Rivitalizimi i sheshit qendror e trotuareve të akseve kryesore të qytetit Divjakë	183,500,853	128,450,597	55,050,256
Qarku Gjirokastër					
14	Bashkia Përmet	Rikualifikim urban i qendrës së qytetit, fasadat, ndricimi, lulishtja, qyteti Përmet	102,800,358	71,960,251	30,840,107
15	Bashkia Gjirokastër	Rikonstruksion i Rrugës Sheshi Cercizit-Postbllok	250,000,000	175,000,000	75,000,000
16	Bashkia Gjirokastër	Unaza në Qendrën Historike, Zgjerimi i Sheshit të Cercizit-Loti 1	100,000,000	70,000,000	30,000,000
Qarku Korçë					
17	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku, sheshi I poliklinikës, sheshi i xhamisë, sheshi i pazarit, rruga e Mborjes, rruga e Ravonikut	290,388,929	203,272,250	87,116,679



18	Bashkia Korçë	Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës/ Muzeu i Artit Mesjetar	143,444,390	100,411,073	43,033,317
19	Bashkia Ersekë	Rikonstruksion i sheshit, faza e 2-të, Ersekë	9,500,000	7,600,000	1,900,000
20	Bashkia Maliq	Rikonstruksioni i cative dhe fasadave të objekteve në rrugën kryesore, qyteti Maliq	53,407,784	37,385,449	16,022,335
Qarku Kukës					
21	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikualifikim urban i sheshit qendror të qytetit, ritrajtim i fasadave, rehabilitim dhe ndricim i rrugëve të brendshme të qytetit Kukës	216,000,000	151,200,000	64,800,000
Qarku Shkodër					
22	Bashkia Shkodër	Rikualifikim urban i rrugicave në Qendrën Historike (shtrimi i rrugicave me gurë dhe montimi i dyerve dekorative prej druri)	61,847,832	43,293,482	18,554,350
Qarku Vlorë					
PROJEKTE RIVIERA					
23	Këshilli i Qarkut Vlorë	Pikë panoramike dhe sportive në Llogara	16,913,231	11,839,262	5,073,969
24	Këshilli i Qarkut Vlorë	Krijimi i një shtegu tracking në kanionin e Gjipesë	9,812,601	6,868,821	2,943,780
25	Këshilli i Qarkut Vlorë	Pikë turistike vrojtimi në Porto Palermo	651,766	456,236	195,530
AGJENCI ZBATUESE					
26	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i qendrës sportive për sportin "Rafting"	52,032,045	36,422,432	15,609,613
27	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Projekti i zgjerimit të rrugës së Doganës "Morinë"	60,000,000	42,000,000	18,000,000
TOTALI			2,862,279,534	2,004,545,675	857,733,859

Shënim:

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).
2. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR për vitin 2016.
4. Në projektet e financuara më sipër (specifikisht, projektet: 2,11,15,16, 17, 18, 22,25), ku do të ndërhyet në zona me rëndësi për trashëgiminë kulturore, kontraktues bashkitë do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore".

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 80 lekë